    - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;
    - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;

c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

## **SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE**

Shtojca 1. Formulari i Ofertës

Shtojca 2. Listat e Çmimeve sipas zërave të preventivit

Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6. Grafiku i realizimit të punimeve

Shtojca 7: Formularët e Përshtatshmërisë dhe Kualifikimit të Ofertuesve

Shtojca 8: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 9: Formulari i Vlerësimit

Shtojca 10: Preventivat e Punimeve

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.

Shtojca 12 - Formulari i Njoftimit të Fituesit

Shtojca 13 Formulari i Njoftimit të Fituesit (Pas procesit të ankimit) .

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër  
(Pas procesit të ankimit)

## Shtojca 1.

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

### FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'ë realizojmë për Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), punimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në preventiv, me të gjitha projektet teknike, e me kërkesat në detyrën e projektimit apo termat e referencës, nëse është rasti, dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
  - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
  - 2. Njoftimin e Kontrates;
  - 3. Kriteret e Vlerësimit;
  - 4. Kriteret e Përzgjedhjes;
  - 5. Specifikimet teknike, Projektet dhe çdo dokumentacion teknik;
  - 6. Preventivin e çmimeve
  - 7. Termat e referencës (nëse është rasti)
  - 8. Detyrën e projektimit (nëse është rasti)
  - 9. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
  - 10. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë]

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	

**Shtojca 2.**

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

**LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT****Data:** \_\_\_\_\_**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** \_\_\_\_\_**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë zërave në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa çmim do të konsiderohen si zëra të paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

**Oferta ekonomike e detajuar**

<b>Nr</b>	<b>Nr. Analizë</b>	<b>Përshkrimi i Punëve</b>	<b>Njësi</b>	<b>Sasia</b>	<b>Çmimi/ Njësi</b>	<b>Cmimi total</b>
1.						
2.						
3.						
<b>Shuma</b>						
<b>Fondi Rezervë</b>						
<b>Shuma</b>						
<b>TVSH</b>						
<b>SHUMA TOTAL</b>						

**Nënshkrimi i ofertuesit** \_\_\_\_\_**Vula****Shënim:** Çmimet duhet të shprehen në Monedhën \_\_\_\_ ( e kërkuar në dokumentat e tenderit )



### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

### FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit /entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

#### **Shtojca 4.**

*(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)*

#### **Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### **VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **Përfaqësuesi i Ofertuesit**

#### **Nënshkrimi**

#### **Vula**

## Shtojca 5.

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor ]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

**Referuar projekteve teknike të zbatimit , relacioneve perkatese dhe specifikimeve teknike perkatese per cdo objekt te kesaj kontrate. “ Bashki me shfrytezim inteligjent Energjie” ( Bashki te zgjuara energjie) .**

**Të dhënat teknike të punëve objekt prokurimi duhet** të përshkruhen sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

SHËNIM: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës.Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Skicimet, parametrat teknik etj: Bashkengjitur Projekt , Relacion, Specifikime teknike, Auditim

Specifikimi i Materialeve: Bashkengjitur Projekt , Relacion, Specifikime teknike, Auditim

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: Bashkengjitur. Projekt , Relacion, Specifikime teknike, Auditim

## Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

### GRAFIKUT I ZBATIMIT TË PUNIMEVE

**Afatet e realizimit të punimeve: 8(Teter) muaj**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3. Afati i realizimit</i>							
		Java 1/Muaji 1	Java 2/Muaji 2	Java 3/Mua ji 3	Java 4/Muaji 4	Java 5/Mua ji 5	Muaji 6	Muaji 7	Muaji 8
1.									
2.									
3.									
4.									

Shënim. Autoriteti/enti kontraktor mund të shtojë rreshta në varësi të zërave të punimeve dhe kollona në varësi të afatit të parashikuar për realizimin e tyre.

## Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]  
**FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**

### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojces 8.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Kompania/Shoqeria që do të realizojë Zbatimin e Teknologjise LED për rruget e zgjedhura duhet të plotësojë keto kushte të përgjithshme:

- Kompania/Shoqeria që do të realizojë Zbatimin e Teknologjise LED për rruget e zgjedhura do të propozojë ekspertët në disipinat që ajo gjykon të nevojshme në mënyrë që të mbulohet i gjithë qëllimi i punës i përshkruar sipas këtyre Termave të Referencës dhe të përgatiten kërkesat e paraqitura.
- Duhet të ketë një staf minimal permanent dhe zyre të pajisur me të gjitha pajisjet në Shqipëri.
- Kompania/Shoqeria që do të realizojë Zbatimin e Teknologjise LED për rruget e zgjedhura duhet të sigurohet që të ketë ekspertizë me kualifikimin e duhur, të identifikohet dhe t'i përshtatet kërkesave për secilën nga detyrat e listuara më sipër. Nisur nga dimensionimi dhe kompleksiteti i punës për t'u realizuar, grupi i ekspertëve duhet të ketë karakter shumë-disiplinor ku përfshihen profesionistë të cilët do të:
  - Adresojnë EE gjatë zbatimit të ndricimit me teknologji LED të rrugëve;
  - Ofrojnë zgjidhjet më të mira në lidhje me EE gjatë zbatimit të ndricimit me teknologji LED të rrugëve (dmth të plotësojnë të gjitha kërkesat sipas projektit inxhinjër të zbatimit të ndricimit me efikasitet të lartë, cilësi të lartë, jetëgjatësi të madhe të pajisjeve dhe kosto të ulët të mirëmbajtjes);
  - Adresojnë gjatë zbatimit të ndricimit me teknologji LED të rrugëve çështjet pikëpamjet shumë-disiplinore të anës elektrike, mekanike dhe arkitektonike;
  - Minimizojnë ndikimin mjedisor si dhe ndikimin në ekosisteme;
  - Minimizonje ndotjen nga ndricimi mbi normat e lejuara gjatë zbatimit të ndricimit me teknologji LED të rrugëve për secilën rrugë të zgjedhur;
  - Transferojnë njohuri tek MEMU në lidhje me ndricimin eficient gjatë zbatimit të projektit;
  - Integrojnë apo adaptojnë eksperiencën e tyre në projekte të ngjashme të ndricimit me teknologji LED.

Kompania/Shoqeria që do të realizojë Zbatimin e Teknologjise LED për rruget e zgjedhura do të mbështetet nga Ekipi i Menaxhimit të Energjisë i Bashkisë Shkoder, ndaj ata duhet të ndërtojnë një marrëdhënie konstruktive, si dhe një transferim efektiv të njohurive. Kompania/Shoqeria që do të realizojë Zbatimin e Teknologjise LED për rruget e zgjedhura duhet të përfshijë në propozim edhe metodën e bashkëpunimit me stafin e MEMU të bashkisë.

Ofertuesit nuk kanë të drejtë të dorëzojnë oferta dhe do të përjashtohen për arsye të mëposhtme:

- Pjesëmarrja e një Ofertuesi përjashtohet nga sanksionet e lëshuara nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së dhe Agjencia Shqiptare e Prokurimit Publik;
- Një Ofertues nuk do të pranohet nëse i është ndaluar pjesëmarrja në projektet e financuara nga SECO. Për më tepër, një ofertues nuk do të propozojë asnjë nënkontraktor të ndaluar nga pjesëmarrja në projektet e financuara nga SECO.
- Ofertuesi është ose ka qenë i përfshirë si konsulent në përgatitjen ose zbatimin e projektit. E njëjta gjë vlen për një ndërmarrje ose një individ që është i lidhur ngushtë me Ofertuesin nën një grup kompanish ose një lidhje të ngjashme biznesi, ose për disa ndërmarrje ose individë të lidhur përkatësisht;
- Mosdorëzimi i një deklaratë sipërmarrjeje në përputhje me modelin standart sipas Procedurave të Prokurimit Publik Shqiptar. Të gjithë ofertuesit e përfshirë në një proces prokurimi të financuar nga SECO dhe Bashkia duhet të sigurojnë një konkurrencë të drejtë dhe transparente dhe të paktën të respektojnë ato Standarde Themelore të Punës që janë ratifikuar nga Shqipëria. Kjo duhet të dokumentohet nga një deklaratë përkatëse e sipërmarrjes e të gjithë ofertuesve të përfshirë në procesin e tenderimit. Deklarata e sipërmarrjes duhet të nënshkruhet në një mënyrë ligjrisht të detyrueshme nga përfaqësuesi i autorizuar në mënyrë të duhur nga ofertuesi. Mosdorëzimi i kësaj deklaratë dhe mospërputhja me kërkesat do të sjellë përjashtimin nga tenderi.

- Ofertuesi është i ndaluar ligjërisht nga procesi i prokurimit në vendin e Autoritetit Kontraktor për arsye të shkeljeve të mëparshme të rregulloreve për mashtrim dhe korrupsion;
  - Në përputhje me politikën e SECO-s për zero-tolerancë ndaj korrupsionit, Konsulentët ose ndonjë prej filialeve të tyre nuk do të punësohen për asnjë detyrë në rast të pretendimeve të vërtetuara për korrupsion në këtë drejtim. Ofertuesi ka detyrimin të informojë SECO-n për çdo pretendim të tillë kur dorëzon një propozim. Ofertuesi që nuk e përmbush këtë detyrim, mund të përjashtohet nga tenderi.
  - SECO ka miratuar një politikë zero tolerance ndaj praktikave korruptive në lidhje me diskriminimin dhe ngacmimin, veçanërisht ngacmimin seksual. Asnjë nga anëtarët e stafit të SECO dhe asnjë nga organizatat partnere, qeveritë partnere, partnerët zbatues dhe kontraktorët nuk do të diskriminojnë ose frikësojnë në asnjë mënyrë ndonjë person të përfshirë në ndonjë aktivitet të kërkuar nga aktivitetet dhe projektet e SECO për shkak të gjinisë, racës, besimit, ose ngjyres. Të gjitha incidentet dhe pretendimet në lidhje me ngacmimet seksuale do të hetohen seriozisht dhe menjëherë. Çdo person i kontraktuar nga SECO ose i përfshirë në aktivitetet dhe projektet e saj që zbulohet se ka ngacmuar seksualisht një tjetër do të pushohet nga puna. Ofertuesi ka detyrimin të informojë SECO-n për çdo pretendim të tillë kur dorëzon një propozim. Ofertuesi që nuk përmbush këtë detyrim, mund të përjashtohet nga tenderi.
  - Ofertuesit ose nënkontraktorët që do të kontraktohen për pjesë të konsiderueshme të kontratës janë ndërmarrje të ndërthurura ekonomikisht me Autoritetin Kontraktor në vendin pritës dhe/ose ndërmarrje të kontrolluara nga shteti që nuk janë ligjërisht ose financiarisht të pavarura.
  - Ofertuesi mund të dorëzojë ose të marrë pjesë, në çfarëdo cilësie, vetëm në një tender. Dorëzimi ose pjesëmarrja nga një ofertues në më shumë se një tender do të rezultojë në refuzimin e të gjitha ofertave për atë kontratë në të cilën pala është e përfshirë. Megjithatë, i njëjti nënkontraktor mund të përfshihet në më shumë se një tender.
- Për t'u kualifikuar për dhënien e kontratës, ofertuesi duhet të plotësojë kriteret e kualifikimit.

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

### 1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*
- Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
- Ofertuesit duhet të paraqesin letrën e vetëdeklarimit në lidhje me Sanksionet në Qeverisë Zvicerane lidhur me konfliktin në Ukrainë , sipas Aneksit 1 Bashkelidhur.*

### 2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

#### 2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

*Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik sipas Shtojcës 8.*

#### 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019-2020-2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e kontratës që prokurohet dhe konkretisht **65,687,642** (Gjashtedhjetë e pese milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e dyzet e dy ) lekë.

*Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare*

**2.2.2.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019, 2020 dhe 2021, të certifikuar nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatim Taksave) ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit

**2.2.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitetet për vitin 2022 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2022.

*Kriteri konsiderohet i permbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **50%** e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: **32,843,821** (Tridhjetë e dy milion e teteqind e dyzet e tre mijë e teteqind e njezet e nje ) lekë dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet dhe konkretisht **131,375,284** (Njeqind e tridhjetë e një milion e treqind e shtatedhjet e pese mijë e dyqind e tetëdhjetë e kater) lekë)

Me punë të ngjashme do konsiderohen punët në: (i. ndricimi i rrugëve me teknologjinë LED, ii. ndricimi me LED i stadioneve, iii. ndricimi me LED i spitaleve, iv. ndricimi me LED i hoteleve, v. ndricimi me LED i ndertesave të medha komerciale and vi. ndricimi me LED i ndertesave publike):

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
  - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
  - Kontratë Sipërmarrje
  - Situacionin përfundimtar;
  - Aktin e kolaudimit;
  - Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
  - Kontrate Sipërmarrje;
  - Situacionin përfundimtar;
  - Akt kolaudimi objekti;
  - Çertifikatën e marrjes në dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim.
  - Fature tatimore përkatëse.

**2.3.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me liçencë profesionale sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e cila të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

#### **Punime të përgjithshme ndërtimi:**

Kategoria NP-1 Niveli A “Punime germimi në tokë”



Kategoria NP-4 Niveli A “Rruge, autostrada, mbikalime...”

Kategoria NP-11 Niveli B “Ndertime per N/Stacionet kabinat e transformatoreve..”

**Punime speciale ndertimi:**

Kategoria NS-1 Niveli A “Punime per prishjen e ndertimeve ...”

- 2.3.3** Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt te paktën:

1(nje)inxhinier ndertimi

1(nje) inxhinier elektrik

1(nje)Inxhinjer topograf, rilevime inxhinierike

Inxhinieret e mësipërm duhet të jenë të siguar dhe të figurojnë me kohë të plotë në listëpagesat perkatese E-Sig për të paktën **3(tre) muajt e fundit**

Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Kontratën individuale të punës, Diplomën e inxhinierëve të mësipërm.

*Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

- 2.3.4** Vetdeklarimin nga inxhinieri ndertimit, elektrik dhe topograf se ata jane te disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate.

- 2.3.5** Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktoje **Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt**, i cili duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë me profesion inxhinier elektrik dhe të deklaroje se ai është i disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate. Bashkelidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; a) Kontrata e punës e vlefshme dhe b) Diploma.

*Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

- 2.3.6** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për realizimin dhe zbatimin e kontratës. Numri mesatar i punonjesve të siguar për **muajin e fundit** duhet te jetë **32 (Tridhjetë e dy)**.

Lidhur me këte pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese vertetim të lëshuar nga Dega e Tatim Taksave ose Dega e Sigurimeve Shoqerore dhe Shëndetsore në të cilin të jetë i percaktuar numri i punonjesve të siguar për periudhen e mësipërme , shoqëruar me listëpagesat perkatese E-Sig, për kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shëndetsore.

*Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

- 2.3.7** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjes të pasqyruar në listëpagesa për të paktën **muajin e fundit**, te paisur me kontrate pune (te vlefshme), ose te kontraktuar posacerisht per te realizuar kete kontrate apo ne rastin kur makinerite jane me qera per manovraret, me deshmi kualifikimi të sigurimit teknik (te vlefshme) të lëshuara nga organizma të akredituar për këtë qëllim në Republikën e Shqipërisë, ku nga këta të jenë të paktën:

Murator	10 (dhjete) punonjës
Elektracist	8(tete) punonjes
Teknik ndertimi	1 (nje) punonjes

Manovrator	2 (dy) punonjes
Puntor asfalti	4 (kater) punonjes

Manovratorët duhet të jenë punonjës të specializuar për drejtimin e mjeteve të rënda (Eskavatorist) dhe (Automakinist) dhe për këtë duhet të paraqesin deshmë nga Drejtoria e Shërbimit të Transportit Rrugor ndërsa për teknikun e ndërtimit duhet të paraqitet diploma e shkollës/deshmë nga organe/institute të akredituar.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**2.3.8** Ofertuesi duhet të disponojë minimalisht mjetet e mëposhtme për kryerjen e punimeve, me qëllim realizimin e objektit të prokurimit :

Nr	Mjetet	Sasia
1	Mjet transporti vetëshkarkues mbi 7 ton (kapac.mbajtes)	2 copë
2	Mjet transporti me ngarkesë mbi 1.5 tone	1 copë
3	Autovinc me kosh	2 copë
4	Matrapik	1 copë
5	Betoniere 1-2 m <sup>3</sup>	1 copë
6	Grejder	1 cope
7	Rrul	1 cope
8	Autobitumatrice	1 cope
9	Asfaltoshtruese	1 cope
10	Trapano elektrike	1 cope
11	Aparate Luxmeter për fluksin e ndricimit	1 cope

Si deshmë për plotësimin e kësaj pike Operatori duhet të paraqesë:

- Për mjetet në pronësi që shënohen në regjistra publikë, të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe çertifikatën për transport mallrash brenda vëndit, (e vlefshme).
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre: aktet e zhdoganimit në Republikën e Shqipërisë ose faturat tatimore të blerjes.
- Për të gjitha mjetet e marra me qira, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i kontratës.
- Për mjetet e marra me qera që shënohen në regjistra publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe çertifikata për transport mallrash brenda vëndit, (e vlefshme). Kurse për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre, aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

Periudha e garancisë për defektet është 2 vjet pas marrjes në dorezim të objektit (hartimit të procesverbalit të marrjes në dorezim dhe çertifikates)

**2.3.10** Ofertuesi pjesëmarrës në tender duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar për materialet e

meposhtme ne menyre qe autoriteti kontraktor te gjykoje nese malli i ofruar ploteson kerkesat teknike te percaktuara ne specifikimet teknike.

1. Autorizim te prodhuesit/Distributorit te autorizuar per mallrat e kerkuara. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij. Ne rast se do te paraqitet autorizim distributori operatori ekonomik ta vertetoj kete duke paraqitur kontratë premtimi, letër angazhimi / akt-marreveshje lidhur mes Kompanisë prodhuese dhe Distributorit të autorizuar.

2. Katalogun/et ose skedat teknike per te gjitha mallrat e kerkuara, te cilat duhet te perputhen me pershkrimin e bere ne specifikimet teknike dhe çertifikatë/deklaratë konfirmimit CE. Ne rast se dokumentet e mesiperme jane në gjuhë të huaj ato duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Nr	Pershkrimi	Njesia	Sasia
1	Ndriçues dekorativ led/ > 10.000 lumen/ 4000k+ krahun	cope	1
2	Ndricues dekorativ led/ >10.000 lumen/ 3000k ( I varur)	cope	1
7	Kuader komandimi	cope	1
8	Kabell 3x1.5 mm <sup>2</sup>	ml	1
9	Kabell 4x6 mm <sup>2</sup>	ml	1
10	Kabell 4x10 mm <sup>2</sup>	ml	1
11	Percjelles tokezimi bakri S=16mm <sup>2</sup>	ml	1
12	Krah nje degesh per shtylle metalike	cope	1

2.3.11 Operatori ekonomik i shpallur fitues brenda (7) shtate diteve nga marrja e njoftimit te klasifikimit duhet te paraqese mostrat per artikujt si me poshte .Mos paraqitja e mostrave prane Bashkise Shkoder, Drejtoria e Sherbimeve Publike ose mos perputhja e tyre me specifikimet teknike te publikuara perben kusht per skualifikim dhe AK do te vazhdoje me shpalljen fitues te ofertuesit te radhes ne renditje.

Nr	Pershkrimi	Njesia	Sasia
1	Ndriçues dekorativ led/ > 10.000 lumen/ 4000k+ krahun	cope	1
2	Ndricues dekorativ led/ >10.000 lumen/ 3000k ( I varur)	cope	1
7	Kuader komandimi	cope	1
8	Kabell 3x1.5 mm <sup>2</sup>	ml	1
9	Kabell 4x6 mm <sup>2</sup>	ml	1
10	Kabell 4x10 mm <sup>2</sup>	ml	1
11	Percjelles tokezimi bakri S=16mm <sup>2</sup>	ml	1
12	Krah nje degesh per shtylle metalike	cope	1

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Informacion për ofertuesit:** Kjo kontratë bashkëfinancohet nga SECO dhe MIE bazuar në Marrëveshjen kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës të Shqipërisë dhe Këshillit Federal Zviceran “Për Bashkëpunimin teknik,financiar dhe humanitar” te lidhur ne daten 11.05.2007 dhe e ratifikuar me Ligjin Nr 9801 datë 13.09.2007“, Marrëveshjen datë 12.11.2021 “Mbi dhenien e asistencës teknike dhe financiare në kuadrin e “Projektit të Bashkive me Energji Inteligjente”(SEMP),të lidhur ndërmjet

*Këshillit të Ministrave dhe Konfederatës Zvicerane, Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Bashkisë Shkoder dhe Sekretariatit të Shteti Zviceran për Çështjet ekonomike (SECO) “Për zbatimin e projektit per bashkitë me shfrytëzim inteligjent te energjisë (SEMP)” dhe Manuali i operimit datë 10.04.2022 “Investime me zbatim të shpejtë për ndriçimin LED të rrugëve:Proceset e realizimit të punimeve dhe flukset financiare” i përgatitur nga Konsorciumi SEMP.*

**VII.** *Konsorciumi i Zbatimit SEMP do të ndihmojë bashkinë në vlerësimin e ofertave dhe në përgatitjen e një raporti vlerësimi.Përzgjedhja dhe shpallja e fituesit do të duhet të marrë një përgjigje pa “Asnjë kundërshtim dmth Aprovim” nga SECO.*

**VIII.** *Kontrata ndërmjet bashkive dhe kontraktorëve do të rishikohet nga Konsorciumi i Zbatimit të SEMP dhe do të duhet të marrë një përgjigje pa “Asnjë kundërshtim dmth Aprovim” nga SECO.*

*(Aneks për tu paraqitur nga operatori ekonomik)*

**Aneksi 1: Modeli i letrës së vetëdeklarimit në lidhje me Sanksionet në Qeverisë Zvicerane lidhur me konfliktin në Ukrainë**

Drejtuar: **Bashkise SHKODER** në kuadrin e Projektit SEMP

.....[Emri i Operatorit Ekonomik]  
..... [Adresa e plote e Zyres kryesore të Kompanisë]

I nderuar Zonje/Zoteri,

kjo leter merr parasysh respektimin e masave sanksionuese në lidhje me situatën në Ukrainë dhe në veçanti me zbatimin e statusit aktual të Urdhëresës së Qeverisë Zvicerane për Masat në lidhje me situatën në Ukrainë (SR 946.231.176.72)

..... [Emri i Operatorit Ekonomik] vlerëson fuqishëm mbështetjen e dhënë nga Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO) për programin SEMP për Bashkitë Pilote në Shqipëri duke përfshirë edhe Bashkinë e SHKODRES

Ne, si Operator Ekonomik, kemi marrë parasysh masat e marra nga Qeveria Zvicerane në lidhje me situatën në Ukrainë dhe në veçanti zbatimin e statusit aktual të Urdhëresës për masat në lidhje me situatën në Ukrainë të datës 4 Mars 2022 (SR 946.231.176.72) dhe amendamentet e saj të mëvonshme (në tekstin e mëtejshëm do të quhet shkurt "Urdhëresa").

Nëpërmjet kësaj letrë, në lidhje me për programin SEMP për Bashkitë Pilote në Shqipëri duke përfshirë edhe Bashkinë e SHKODRES, si Administratori i Operatorit Ekonomik unë Ju jap garanci se [Shoqëria .....] nuk do të përdorë fondet e SECO-s në asnjë mënyrë që do të ishte në kundërshtim me Urdhëresën e sipër-përmendur.

Mbi këtë bazë, ne se Shoqëria/Kompania jone do të zgjidhet si fituese dhe do të zbatojë këtë projekt do të isha mirënjohës për transferimin e fondeve sipas planit të pagesave të përshkruara në marrëveshjen e financimit duke ju referuar gjithmone të gjithë kushteve dhe kërkesave të dokumentave standart të tenderit.

Nr	Emri i Dokumentit Name of Document	Lëshuar nga: Issued by:	Kontrolluar nga: Checked by:	Kontrolluar nga MEMU dhe mbështetur nga SEMP Consortium dhe Checked and verified by the respective Municipal Energy Management Units (MEMU) and supported by SEMP Consortium and through their signatures they confirm the compliance of the respective documents.
1	Pro-fatura (ditë) shërbuesit me cilësimet e punës dhe shpenzimet përfaqëse) lëshohet nga Kontraktori dhe paguar qoftë: i) pjesën pa TVSH; ii) TVSH; iii) totali me TVSH. Proforma invoice (bill of quantities with their respective expenses) is issued by the Contractor by showing clearly: i) part without VAT; ii) VAT; iii) total with VAT	Kontraktori/Contractor	Mëqortësi Supervisor Bashkia Municipality Konsortiumi SEMP SEMP Consortium	MEMU SEMP Consortium
2	Mëqortësi aprovon Pro-faturën - Supervisor's approval of proforma invoice		Mëqortësi Supervisor	
3	Bashkia aprovon Pro-faturën - Municipality's approval of proforma invoice		Bashkia Municipality	
4	Pro-fatura shqyrtohet edhe nga Kom. SEMP dhe sugjerohet SECO-s për aprovim. Proforma invoice is reviewed by the SEMP Consortium and is suggested to Swiss State Secretariat for Economic Affairs (SECO) to issue 'no-objection'		Konsortiumi SEMP SEMP Consortium	
6	Fatura elektronike zyrtare përfundimtare lëshohet nga kontraktori Final Official e-Invoice is issued by Contractor	Kontraktori Contractor	Bashkia Municipality	
7	Autorizimi i pagesës nga kryetari i Bashkisë si person autorizuar garues dhe Drejtori i Financave si person autorizuar ofrues. Authorization of payment by the Mayor, as primary authorized person, and the Director of Finance, as secondary authorized person	Nyrtari i Bashkisë & Drejtori i Financave Mayor and the Director of Finance	Bashkia Municipality	
8	Intesa San Paolo Banki do të paguajë vetëm pjesën e fakturës pa TVSH në bazë të marrëveshjes ndërmjet SECO dhe MIE. Intesa San Paolo Bank shall pay only the part of the invoice without VAT based on the project agreement signed between the SECO and the Ministry of Infrastructure and Energy (MIE), 12.11.2021	Banka Intesa San Paolo Intesa San Paolo Bank	Banka Bank	
9	MIE do të paguajë vetëm pjesën e TVSH-së të fakturës në bazë të marrëveshjes ndërmjet SECO dhe MIE. MIE shall pay only the VAT part of the invoice based on the project agreement signed to the SECO and MIE, 12.11.2021	MIE	MIE MIE	

Ne mbetemi në dispozicionin tuaj nëse keni ndonjë pyetje dhe falenderojme edhe nje here mbështetjen e vazhdueshme të Qeverisë Zvicrjane dhe SECOs për Bashkinë e SHKODRES

Juaji Sinqerisht,

Z./Znj. ....

Administratori i Shoqërisë

## Shtojca 8

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik

\_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

#### PJESA I: A. INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK

Identifikimi	Përgjigjja
--------------	------------

Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

## B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

--	--	--	--

## Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

### A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

<b>Deklarata</b>
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <p>_____</p> <p>_____</p> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>



Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

## **B: DEKLARATA**

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
  - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
  - b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
  - a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
  - b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe

shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).

7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
- a) çmimet ;
  - b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
  - c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
  - d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.
8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

## C: DEKLARATA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

### Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

